

VENDIM
Nr. 480, datë 26.6.2026

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT), NË BASHKITË KRUIJË E KURBIN, DHE CAKTIMIN E BASHKIVE KRUIJË E KURBIN SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjeve “i” e “iii”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 300 618 237,34 (treqind milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të klasifikuar si objekte të pabanueshme, që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bazë të aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Krujë e Kurbin, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 196 476 027 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi, në masën 104 142 210, 34 (njëqind e katër milionë e njëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e dhjetë presje tridhjetë e katër) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe i transferohet bashkive Krujë e Kurbin, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Krujë e Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu